ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E VUSHTRRISË

Për Aktivitetin e Prokurimit : **VU644-23-6530-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit Stanoc,Dumnicë ,Pasome , Beqiq , Duboc, Bequk,Stroc ,Zhilivod dhe ne Prelluzhë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

DIAMANTI SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Naim Frashri nr. 16 Prishtine
(Adresa)

Prishtine — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 776 839 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Azem Tahiraj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkdiamanti@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.08.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë : **06.07.2023**
Data e planifikuar e hapjes së ofertave: **14.08.2023**
Kërkesa për rishqyrtim: **08.08.2023**
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: **14.08.2023**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 27 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 71 i LPP-së** **Neni 18.9 i RRUOPP-së** **Neni 26.4 i RRUOPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht ju rikujtojmë se për këtë aktivitet të prokurimit kemi bërë kërkesë për informata shtesë me dt: 07.07.2023, si dhe kerkese per rishqyrtim me dt: 08.08.2023.
Ku kemi kërkuar nga AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit projektin në formë elektronike (PDF dhe DWG) në mënyrë që të jetë e detajizuar se në cilën pjesë do të bëhet ekzekutimi i punimeve në Vushtrri, gjegjësisht është e rëndësishëm për organizimin e planit dinamik, furnizimit të gypave,pompave, ofertës financiare si dhe për arsyje të mungesës së vizitës në terren.
Kryesisht **nevojitet projekti i rrjetiti të shtrirjes të gypave , projekti i pompave(sepse pompat ne paramase jan kerkuar qe invertori te jete inkuadruar brenda tyre si dhe jane kerkuar panel komandues me invertor do te thot invertoi esht kerkuar dy here tek poz. 6.1 dhe 6.2), nevojitet projekti i elektrikes(eshte e pa mundur ekzekutimi i elektrikes ne paramase pa projekt detal), si dhe detale te nyjeve, detale te pusetave dhe fazonerive** si dhe ku AK-ja ka planifikuar të vendosni këta gypa sepse është kufizuar tej mase konkurrenca dhe mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit, sepse eshte e pa mundur ekzekutimi ketyre punimeve pa hartuar projekt detal.

Në përgjigjjen e kërkesës për informata shtesë **AK-ja jep një sqarim ku thotë që nuk ka projekt të perpiluar për ekzekutimin e ketyre punimeve per arsye se nga AK-ja nuk ka kontrate te lidhur me kompani projektuese.**
Ndersa ne përgjigjjen e kerkeses per rishqyrtim AK-ja nuk e komenton fare kerkesen qe kemi bere per tenderin e inicuar pa hartuar projekt ekzistues.

Ju sqarojmë se AK-ja ka inicuar këtë aktivitet të prokurimit, pa hartuar fillimisht një projekt. Me këtë veprim ju keni rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 19.17 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, ku përcaktohet qartë *"Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtron, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen.* ***Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes se tenderit.*** *Gjithashtu* keni rënë në kundërshtim me LPP nr.28 Paragrafi 10: ***Asnjë Autoritet Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit."***

Pra në këtë rast AK-ja nuk e ka respektuar dispozitën e lartcekur, pasi që keni inicuar aktivitetin e prokurimit, pa hartuar një projekt ekzekutues. Ju informojme se projektet hartohen me qellim qe te mos kete nevoje per ritenderim dhe pune shtese.Kjo jo vetem qe ka kosto shtese financiare per komunat,po shkakton edhe hubje te kohes me shtim te procedurave.

Ne kete rast **AK-ja** ka kufizuar tej mase konkurrencen dhe mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit dhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Ku me këtë po e bëni të pamundur ofertimin edhe për OE me përvojë të madhe në këtë fushëveprim pasi qe ne si OE me pervoje shum te madhe ne ndertim te ujesjelleve kemi hasur ne mangesi te te dhenave ne paramase si **dhe oferta financiare ka kosto me te madhe se sa buxheti i parapre ne kete projekt.**

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit me LPP-së dhe aktiviteti duhet te anulohet ku se pari duhet te hartohet projekti detal pastaj te filloni me incimin e aktivitetit te prokurimit.

Ju informojme se kemi nje vendim te OSHP me nr 727/22 ku thuhet qarte se AK-ja e ka te ndaluar te filloi me proceduara te prokurimit pa hartuar projekt ekzistues, sepse e keni obligim ligjor.

- **Gjithashtu tek Aneksi 8 AK-ja ka kerkuar: Buldozier D4**

Vlersojmë se eshte kriter i pa nevojshme dhe e pa justifikuar, është kriter(Diskriminues), që e kufizojnë konkurrencën dhe kërkojmë që ky kriter të largohet nga dosja e tenderit,sepse me këtë kërkesë po tentohet të favorizohen kompani të caktuara e cila do ta ofronte një mekanizem të tillë, dhe rrjedhimisht kjo kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e punimeve në këtë tender,sepse ne ndertim te ujesjellesve nuk nevoitet nje Buldozer I tille dhe me peshe kaq te madhe mbi 13 ton I cili perdoret vetem ne gurthyes si dhe ne ndetim te rrugeve, dhe nuk ka ndonjë efekt-ndikim ne ket projekt dhe nuk hyn ne pun fare,sepse ka vetem hapje dhe mbulim kanali.

Me këtë kërkesë po tentohet te favorizohet një kompani e caktuar e cila do ta ofronte, Prandaj kërkojmë nga ju si autoritet ta largoni këtë kërkese nga dosja e tenderit
AK-ja me qëllim ka kërkuar pajisje te pa nevojshme e që nuk do te përdoren pothuajse fare ne këto punime, mirëpo këto kërkesa vetëm sa po i ngarkojnë operatoret ekonomik dhe po i shtyni drejt heqës dore për te konkurruar në këtë aktivitet te prokurimit, prandaj edhe për këtë kërkesë te pa nevojshme ne kërkojmë që ti largoni në tërësi.

Kërkojmë nga ana juaj që të analizoni në tërësi dosjen e tenderit dhe të bëni ndryshimet e nevojshme, konform kërkesave tona të cilat janë të bazuara në dispozita ligjore.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6.
Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur dhe natyrisht që mundësia e dëmtimit të buxhetit është shumë e madhe.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".*
Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar

"DIAMANTI" SH.P.K
DIAMANTI
Prishtinë

automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

AK-ja në këtë rast me këto kërkesa, nuk e ka pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*". Pra jo vetëm që po ju pamundësoni ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur, por po ju pamundësoni ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

AK-ja me kërkesat e lartcekura të cilat ia keni përshtatur një OE të caktuar po e rrezikoni dëmtimin e buxhetit të shtetit, pasi që në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE të cilët i plotësojnë këto kërkesa do të ofertojnë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që "*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender pa projekt detal, ne e konsiderojmë tender **të kurdisur** dhe normalisht që nëse nuk ndryshohen kërkesat do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "***DIAMANTI SH.P.K***

ANULOHET, ky aktivitet i prokurimit pa projekt ekzistues si dhe kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së, te hartohet fillimisht projkti pastaj te inicohet aktiviteti i prokutimit.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen në vlerë prej 5,000.000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

"DIAMANTI" SH.P.K
DIAMANTI
Prishtinë

DIAMANTI

Tema: **Kërkes për informta shtesë**

Për: **KOMUNA E VUSHTRRISË**

Nga : ***DIAMANTI SHPK***

Referenca: **VU644-23-6530-5-1-1**

Titulli : **Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit Stanoc,Dumnicë ,Pasome , Beqiq , Duboc, Bequk,Stroc ,Zhilivod dhe ne Prelluzhë**

Duke u bazuar në dosjen e tenderit me titull " **Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit Stanoc,Dumnicë ,Pasome , Beqiq , Duboc, Bequk,Stroc ,Zhilivod dhe ne Prelluzhë** " me nr Prokurimit "**VU644-23-6530-5-1-1** " të inciuar nga AK , **KOMUNA E VUSHTRRISË,** Neni IV. Informacione Shtesë kërkojm nga Ak , të na japë këto informacione shtesë :

Kerkesa nga OE Nr.1 :

Ne si kompani në bazë të eksperiencës shumëvjeçare në ndërtimin e ujësjellësve ju njoftojmë se për implementimit të ketij projeketi dhe ofrimin e ofertës financiare ju njoftojmë se per kete ativitet na duhet projekti I detajizuar.

Kërkojmë nga autriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit projektin në formë elektronike (PDF dhe DWG) në mënyrë që të jetë e detajizuar se në cilën pjesë do të bëhet ekzekutimi i punimeve në Vushtrri, gjegjësisht është e rendesishm për organizimin e planit dinamik, furnizimit të gypave,popmave, ofertës financiare si dhe për arsyje të mungesës së vizitës në terren.

Kërkesa e lartëshënuar është për shkak të korrektësisë dhe barazisë të gjithë ofertuesve, sepse pozicionet jane determinuese për caktimin e çmimit të ofertës financiare në këtë projekt.

DT: 07.07.2023

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Diamanti shpk
Rr. "Naim FRASHËRI" Nr.16, Prishtinë
Tel: +383 44 776839
E-mail: shpkdiamanti@gmail.com

"KOMUNA E VUSHTRRISË"

Aktiviteti i prokurimit:
Rregullimi i shtratit te lumit Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit Stanoc,Dumnicë ,Pasome , Beqiq , Duboc, Bequk,Stroc ,Zhilivod dhe ne Prelluzhë

Nr. I Prokurimit[1]	***VU644***	***23***	6530	5-1-1

SQARIME shtese për OE

Te nderuar,
Ne përputhje me nenin 53 te LPP, operatori ekonomik ka kërkuar sqarim shtes lidhur me specifikimet teknike :
Në përputhje me nenin 53 te LPP, ***AK pas shqyrtimit të kërkese së operatorit ekonomik Sqarim për informacion shtesë:***

Pyetja:
Ne si kompani në bazë të eksperiencës shumë vjeçare në ndërtimin e ujësjellësit, ju njoftojmë se për implementimin e këtij projekti dhe ofrertës financiare, ju njoftojmë se per kete aktivitet na duhet projekti i Detajizuar.

Përgjigjja:

Ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues në mungesë të kompanisë për hartimin e projekteve kryesore, për këtë aktivitet nuk e posedojmë projektin ekzekutiv. Mirëpo, nga të dhënat që kemi incizuar në terren, kemi bërë hartimin e paramasës dhe parallogarisë.

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit –Albanez Tahiraj

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. **"DIAMANTI" sh.p.k. me seli në Prishtinë, në procedurën prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Bequk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511,** kundër **Njoftimit për Kontratë të dt. 06.07.2023,** pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më datën **14.08.2023** bie këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e datës **08.08.2023**, e subjektit në procedurë : **"DIAMANTI" sh.p.k. me seli në Prishtinë**, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, Njoftim për Kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës **06.07.2023 lidhur me Kërkesat e FTD-së** të saktësuara në Dosjen e Tenderit në aktivitetin e prokurimit: **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Bequk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511.**
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik do të ndërmarr veprimet procedurale për korrigjimin dhe harmonizimin e **Kërkesave të FTD-së** , në pajtim me këtë vendim dhe në pajtim me korrigjimet e bëra nga Njësia Kërkuese e A.K.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Bequk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511.**

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.- Ankuesi, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, Op. Ek konsideron se **Kërkesat e saktësuara në FTD** shkelin nenin 1, 7, 27, 28, 69 dhe 71 të LPP-së, si dhe nenet 18.9 dhe 26.4 të RrPP-së, sepse, sikurse pretendon Ankuesi Kërkesat e saktësuara në **Kërkesat e FTD-së** të Dosjes së Tenderit, lidhur me mjetet dhe pajisjet në fjalë nuk janë në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe si e tillë paraqesin kufizim të pjesëmarrjes së O.E. në aktivitetin e prokurimit në fjalë, me çka sikurse konsideron Ankuesi Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim, janë shkelur dispozitat e LPP-së të cituara si më lartë në këtë Vendim.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë për bazë dhe rekomandimin e Njësisë kërkuese të Autoritetit Kontraktues, lidhur me korrigjimin e **Kërkesave të FTD-së**, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se, sikurse ka vlerësuar Autoriteti Kontraktues, Kërkesa për pajisjen (**kamion me kran min. 12 ton paraqet lëshim teknik dhe zëvendësohet me kamion me peshë bartëse min. 7 ton**) dhe si të tillë, këtë Kërkesë do ta korrigjoj dhe përshtatë në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit, respektivisht me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ashtu që të jenë gjithëpërfshirëse.

Zgjidhjet e ndërmarra nga A.K. të cilat konsiderohen se i përmbushin dhe kërkesat dhe / ose pretendimet e Ankuesit, të saktësuara në Kërkesën për Rishqyrtim, A.K. do t'i inkorporoj në Dosjen e Tenderit në pjesën – **Kërkesat e FTD-së**, si dhe do t'i ngritë edhe përmes Platformës Elektronike, me qëllim të informimit të të gjithë O.E. të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më lartë, dhe në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv te këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 074/2023, datë 08.08.2023

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik

Albanez Tahiraj

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Vendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve;
2. DPP-së, dhe
3. Arkivit (1 kopje).